



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22 Korrik 2022

Nr: 185

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE”, NDAJ Z. EDISON MEMOLLA KRYETARIT TË BASHKISË RROGOZHINË, Z. DENIS DEDEJ PËRGJEGJËSIT TË QENDRËS KULTURORE “HAXHI MEMOLLA”, ZJ. ANA DHAMO DREJTOR I DREJTORISË RAJONALE ARSIMORE DURRËS, Z. LUAN SHEHI DREJTOR I ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR RROGOZHINË, ZJ. MARGARITA DEDEJ DREJTORIT TË SHKOLLËS “HAXHI QEHAJ” DHE ZJ. MIMOZA BIDAJ DREJTORIT TË KOPËSHITIT RROGOZHINË, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Sot më datë 22 Korrik 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim në seancë dëgjimore denoncimin që u përket:

**Kërkues:** Organizata “Qendresa Qytetare”

**Objekti:** Promovim investimesh në kundërshtim me kufizimet e neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor

**Ndaj:** Z. Edison Memolla, Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë

Z. Denis Dedej, Përgjegjësiti të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”

Zj. Ana Dhama, Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës

Z. Luan Shehi, Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë

Zj. Margarita Dedej, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj”

Zj. Mimoza Bidaj, Drejtorit të Kopështit “Rrogozhinë”

Data: 22 Korrik 2022  
Nr. 185

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe Drejtorit të Kopështit Rrogozhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”



**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

## V Ë R E N :

### I. Vlerësimi paraprak

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 5 Mars 2022, në portalin e denoncimeve në faqen zyrtare të KQZ-së është raportuar denoncimi me numër ID unik 3684, ku pretendohet se: *“Në datë 16.02.2022, është bërë inaugurimi i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” nga kryetari i bashkisë Rrogzhinë në detyrë, z. Edison Memolla, i cili është gjithashtu edhe kandidat për këtë bashki i Partisë Socialiste në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022, me pjesëmarrjen e Drejtorisë Arsimit, Kulturës dhe Sportit dhe nxënësve të shkollës. Inaugurimi i këtij objekti kulturor vjen vetëm 3 ditë para çeljes së fushatës zgjedhore në referim të vendimit nr. 2, pika 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, konkretisht neni 3, pika 1.1/b dhe 1.1/d, duke promovuar një investim vendor me karakter social dhe kulturor, si objekt i rindërtuar për shkak të fatkeqësive natyrore. Ndër të tjera shihet se në këtë aktivitet janë pjesëmarrës nxënësit e shkollës dhe orari i zhvillimit (ora 11:00) të këtij aktiviteti përkon me orarin mësimor. Gjatë këtij takimi, sikurse vërehet nga statusi në profilin personal në “Facebook” të kandidatit, z. Memolla shkruan: “Ditën e sotme i paraprimë inaugurimit të godinës së re të qendrës së kulturës në mënyrën më të bukur. Pasi të kalojmë fazën e zgjedhjeve lokale, do të pritet shiriti simbolik për hapjen e qendrës. Falënderoj të gjithë ata që kontribuan për realizimin e këtij projekti. Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe nxënësit për aktivitetin e këndshëm me këngë, valle dhe recitime që kishin realizuar”.*



Bashkëlidhur këtij denoncimi janë dërguar pamjet fotografike dhe linku përkatës:

<https://www.facebook.com/edison.memolla.1/posts/338714731502106>

2. Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.
3. Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:
  - dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
  - f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
  - n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.
4. Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.
5. Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se, të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qendresa Qytetare”, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e faktit

6. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator mbi *“Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencie dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*.

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogzhinë, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe Drejtorit të Kopështit Rrogzhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Data: 22 Korrik 2022

Nr. 185



7. Në denoncimin e mësipërm pretendohet se, në ambientet e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, është kryer një takim elektoral që bie në kundërshtim me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor si dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1636 prot., datë 07.03.2022, i është drejtuar z. Edison Memolla, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë si dhe Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, duke i kërkuar informacion sqarues në lidhje me denoncimin e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Organizata “Qendresa Qytetare” në lidhje me organizimin e këtij aktiviteti.
9. Nëpërmjet shkresës nr. 1637 prot., datë 07.03.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka kërkuar Bashkisë Rrogozhinë, informacion në lidhje me financimin e rikonstruksionit të kësaj qendre dhe nëse ka pasur fonde publike të vëna rishtazi apo posaçërisht në dispozicion për ndërtimin e saj.
10. Nëpërmjet shkresës me nr. 912/1 prot., datë 09.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1636/1 prot., datë 11.03.2022, jemi informuar nga Bashkia Rrogozhinë në lidhje me organizimin e aktivitetit në Qendrën Kulturore “Haxhi Memolla”, sipas së cilës, *“Kjo veprimtari ka qenë e planifikuar më parë dhe është raportuar në faqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datë 11.02.2022, në përputhje me nenin 92/2 të Kodit Zgjedhor, pra jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Në këtë veprimtari folësi kryesor ka qënë kryetari i bashkisë dhe pjesëmarrës nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ka pasur pjesëmarrës nga nxënësit e shkollave përveç grupit artistik të kërcimit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe grupit artistik të Kopshtit të Rrogozhinës. Theksojmë se inaugurimi paraprak i kësaj qendre kulturore është bërë për arsye se subjektet zgjedhore kanë kërkuar zhvillimin e takimeve pas hapjes së fushatës elektorale në këtë qendër”*.
11. Nëpërmjet shkresës me nr. 913/1 prot., datë 10.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1637/1/2 prot., datë 15.03.2022, jemi informuar nga Bashkia Rrogozhinë se; *“Bashkia Rrogozhinë është fituese e Skemës së Granteve në Mbështetje të Zonave të prekura nga tërmeti, financuar nga “Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri” (PZHRSR), me projektin me titull “Rikonstruktimi i strukturës dhe hapsirave të Pallatit të Kulturës Rrogozhinë “Haxhi Memolla” në shumën totale prej 40,251,072 lekë. Koha e lidhjes së kontratës mban datën 27.11.2020, pra koha e lidhjes së saj, zbatimi, projekti dhe fakti që nuk kemi të bëjmë me fonde publike por donacione, nuk kanë lidhje me zgjedhjet vendore”*.
12. Nëpërmjet shkresës përcjellëse me nr. 100 prot., datë 09.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1716 prot., datë 11.03.2022, na është vënë në dispozicion shkresa me nr. 98 prot., datë 09.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1636/1 prot., datë 11.03.2022, me anë të së cilës jemi informuar nga Zyra Vendore



Arsimore Rrogzhinë në lidhje me organizimin e aktivitetit në Qendrën e Kulturës, sipas së cilës, *“Kjo veprimtari e planifikuar më parë dhe është raportuar në faqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datë 11.02.2022, në përputhje me nenin 92/2 të Kodit Zgjedhor, pra jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Në këtë veprimtari folësi kryesor ka qenë kryetari i bashkisë dhe pjesëmarrës Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nuk ka pasur pjesëmarrës nxënës të shkollave përveç grupit artistik të kercimit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe grupit artistik të Kopshtit të Rrogzhinës. Theksojmë se inaugurimi paraparak i kësaj qendre kulturore është bërë për arsye se subjektet zgjedhore kanë kërkuar zhvillimin e takimeve pas hapjes së fushatës elektorale në këtë qendër”.*

13. Nëpërmjet e-mail-it të datës 25 Mars 2022, z. Endrin Ajdini në cilësinë e përfaqësuesit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se *“Qendra Kulturore është në varësi direkte nga Bashkia Rrogzhinë. Dhënia e informacionit të kërkuar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është dhënë nga Bashkia Rrogzhinë, prandaj Qendra Kulturore “Haxhi Memolla”, i qendron pretendimeve të dhëna nga Bashkia Rrogzhinë”.*
14. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vijim të procesit të hetimit administrativ të plotë dhe të gjithëanshëm, nëpërmjet shkresave nr. 1930 prot., datë 28.03.2022 dhe nr. 2331 prot., datë 06.05.2022, i përcjell për njohje z. Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogzhinë dhe Organizatës “Qendresa Qytetare” shkresën nr. 100 prot., datë 09.03.2022, administruar me tonën nr. 1716 prot., datë 11.03.2022, të Zyrës Vendore Arsimore Rrogzhinë, shkresën nr. 98 prot., datë 09.03.2022, administruar me tonën nr. 1636/2 prot., datë 11.03.2022, të Zyrës Vendore Arsimore Rrogzhinë, shkresën nr. 913/1 prot., datë 10.03.2022, administruar me tonën nr. 1637/1 prot., datë 15.03.2022, të Bashkisë Rrogzhinë, shkresën nr. 912/1 prot., datë 09.03.2022, administruar me tonën nr. 1636/1 prot., datë 11.03.2022, të Bashkisë Rrogzhinë, shkresa nr. 1637 prot., datë 07.03.2022, drejtuar Bashkisë Rrogzhinë, shkresa nr. 1636 prot., datë 07.03.2022, drejtuar bashkisë Rrogzhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogzhinë. Sipas përcaktimeve të nenit 2, të pikës 15, të vendimit nr. 9, datë 6.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, palët në proces janë njoftuar për të depozituar prapësimet në lidhje me denoncimin e sipërcituar.
15. Me vendimin nr. 155, datë 05 Maj 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për shkelje të parashikuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, Qendrës





Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, sepse hetimi administrativ rezultonte ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

16. Nëpërmjet shkresës nr. 2011 prot., datë 04.04.2022 Organizata “Qendresa Qytetare” depozitoi prapësime në lidhje me denoncimin e raportuar në ndërfaqe. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, nëpërmjet shkresës nr. 193 prot., datë 10.05.2022, administruar me tonën nr. 2371 prot., datë 12.05.2022, depozitoi prapësime në lidhje me denoncimin e pretenduar nga Organizata “Qendresa Qytetare”.
17. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2418 prot., datë 17.05.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 19 Maj 2022, ora 11:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, z. Denis Dedej, përgjegjës i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zj. Ana Dharmo Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zj. Mimoza Bidaj, Drejtorit të Kopështit “Rrogozhinë”.
18. Në seancën dëgjimore të datës 19 Maj 2022, u paraqitën palët në proces, Organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, autorizuar nëpërmjet autorizimit të datës 01.04.2022, dhe z. Helidon Plaku, përfaqësues i Bashkisë Rrogozhinë, autorizuar nëpërmjet autorizimit nr. 2144/1, datë 19.05.2022.
19. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancë publike ju kërkoi palëve të parashtrojnë pretendimet e tyre në lidhje me denoncimin e pretenduar. Gjatë pretendimeve të tij, përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare” zj. Kurti u shpreh se, konfirmon dhe njëherë denoncimin e raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kërkon informacion më të detajuar nga ana e Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë në lidhje me: A ka qenë data 16.02.2022 ditë mësimi dhe deri në çfarë ore ka vijuar procesi mësimor si dhe a kanë patur informacion mbi pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetin e inagurimit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” dhe nëse po kush ka dhënë leje për pjesëmarrjen e nxënësve në këtë aktivitet?  
Zj. Kurti gjithashtu, gjatë pretendimeve të saj në seancë publike, kërkoi informacion shtesë drejtuar Bashkisë Rrogozhinë, si administrator i Qendrës Kulturore nëse janë zhvilluar aktivitete të tjera në këtë qendër pas datës 16.02.2022 (Inagurimit) dhe dërgimin e informacioneve mbi kërkesat e subjekteve të cilat kanë kërkuar përdorimin e qendrës. Pra kalendarin e detajuar të aktiviteteve si dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit të zhvillimit të tenderit dhe përcjelljen e kontratës koncesionare.



20. Gjatë pretendimeve të tij, z. Helidon Plaku në cilësinë e përfaqësuesit të Bashkisë Rrogozhinë deklaroi se, investimi për rikonstrukcion e Qendrës Kulturore ka një vit e gjysmë që ka nisur dhe projekti ka përfunduar në afatin e duhur sipas kontratës; nuk ka lidhje me fushatën por data e përfundimit përkoi me datën kur filloi dhe fushata zgjedhore. Financimi për rikonstrukcionin e Qendrës Kulturore është bërë nëpërmjet një marrëveshje të bërë nga Bashkia Rrogozhinë dhe një fondacion zvicerian. Qendra Kulturore “Haxhi Memolla” është marrë me qera dhe nga subjekte të tjera politike, nëpërmjet një kërkesë të bërë nga palët e interesuara dhe ju është vënë në dispozicion për të kryer aktivitete të ndryshme. Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave për të cilën pretendon Organizata “Qendresa Qytetare” nuk është e vërtetë, pasi në aktivitet kanë marrë pjesë nxënës të grupeve artistike të shkollës, sikurse është pohuar dhe nga Zyra Vendore Arsimore Rrogozhinë.
21. Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve, në përfundim të hetimit administrativ kërkoi nga palët në rast se ka kërkesa shtesë për marrje dokumentacioni dhe asnjëri nga palët nuk kërkoi. Në pretendimet përfundimtare, pas shpalljes së mbylljes së hetimit administrativ, denoncuesi kërkoi pranimin e kërkesave dhe marrjen e masave për denoncuesit, ndërsa bashkia Rrogozhinë kërkoi mospranimin e kërkesëpadisë.
22. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet shkresës nr. 2463 prot., datë 23.05.2022, me lëndë kërkesë për informacion, ju drejtua Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës si dhe Zyrës Vendore Arsimore Rrogozhinë. Nëpërmjet shkresës nr. 2462 prot., datë 23.05.2022, me lëndë kërkesë për informacion ju drejtua Bashkisë Rrogozhinë. Me shkresën nr. 2492 prot., datë 27.05.2022, me lëndë kërkesë për informacion, ju drejtua Drejtorit të shkollës “Haxhi Qehaj”. Nëpërmjet shkresës nr. 2524 prot., datë 31.05.2022, me lëndë kërkesë për informacion ju drejtua Drejtorit të Kopështit Rrogozhinë.
23. Nëpërmjet shkresës nr. 252 prot., datë 24.05.2022, administruar me tonën nr. 2485 prot., datë 27.05.2022, Zyra Vendore Arsimore e Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, informon se data 16.02.2022 ka qenë ditë mësimi normale në IA, nën varësi të ZVAP Rrogozhinë dhe procesi mësimor edukativ ka vijuar në përputhshmëri me orarin mësimor. Nuk kemi patur informacion mbi pjesëmarrje të nxënësve në aktivitetin e inaugurimit të Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, përveç grupit artistik të Kopshtit nr. 1, Rrogozhinë, informacioni i cili është dërguar në rrugë zyrtare me shkresë përcjellëse nr. 100 prot., datë 09.0.2022.
24. Nëpërmjet shkresës nr. 2208/1 prot., datë 24.05.2022, administruar me tonën me nr. 2486 prot., datë 27.05.2022, Bashkia Rrogozhinë, vë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, material plotësues mbi denoncimin e përcjellë nga Organizata “Qendresa Qytetare”.
25. Nëpërmjet shkresës nr. 596 prot., datë 30.05.2022, administruar me tonën nr. 2492 prot., datë 01.06.2022, Drejtori i Gjinnazit “Haxhi Qehaj”, ka bërë me dije se data 16.02.2022, ka qenë ditë normale mësimi dhe mësimi ka vijuar deri në orën 13:50. Në lidhje me pjesëmarrjen e nxënësve në

aktivitet deklararon se nuk ka informacion mbi pjesëmarrjen e nxënësve në inagurimin e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”.

26. Njëpërmjet shkresës nr. 2524/1 prot., datë 03.06.2022, Drejtori i Kopështit Rrogozhinë zj. Mimoza Bidaj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se, *“Në aktivitetin e zhvilluar nuk kanë qenë pjesëmarrës fëmijët e kopshtit por vetëm grupi artistik i fëmijëve, i cili ka performuar”*.
27. Njëpërmjet shkresës nr. 2670 prot., datë 09.06.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve iu përcjell për njohje palëve, shkresat nr. 252 prot., datë 24.05.2022, administruar me tonën nr. 2485 prot., datë 27.05.2022, të Zyrës Vendore Arsimore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, nr. 2208/1 prot., datë 24.05.2022, administruar me tonën me nr. 2486 prot., datë 27.05.2022, të Bashkia Rrogozhinë si dhe shkresën nr. 596 prot., datë 30.05.2022, administruar me tonën nr. 2492 prot., datë 01.06.2022, të Drejtorit të Gjinnazit “Haxhi Qehaj”.
28. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2752 prot., datë 20.06.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 23 Qershor 2022, ora 11:30, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, z. Denis Dedej, përgjegjës i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zj. Mimoza Bidaj, Drejtorit të Kopështit “Rrogozhinë”. Seanca dëgjimore u shty për më datë 28 Qershor 2022, për shkak të disa arsyeve objektive të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Palët u njoftuan elektronikisht për zhvillimin e seancës dëgjimore.
29. Në seancën dëgjimore të datës 28 Maj 2022, u paraqitën palët në proces, Organizata “Qendresa Qytetare” me përfaqësues të saj zj. Teisa Kurti, z. Mirgen Qeraxhi, autorizuar njëpërmjet autorizimit të datës 25.06.2022, dhe z. Eduart Dedej, i autorizuar nga zj. Margarita Dedej Drejtor i shkollës “Haxhi Qehaj”, Rrogozhinë, autorizuar njëpërmjet autorizimit nr. 599, datë 22.06.2022. Palët e tjera në process nuk u paraqitën në seancë dëgjimore.
30. Me çeljen e seancës dëgjimore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u kërkoi palëve të parashtronin pretendimet e tyre. Përfaqësuesi i Organizatës “Qendresa Qytetare” kërkoi fjalën për procedurë, duke deklaruar se pasi jemi njohur me materialet plotësuese të cilat u kërkuan në seancën publike të datës 19 Qershor 2022, nga ana jonë drejtuar Bashkisë Rrogozhinë njëpërmjet kërkesës nr. 2794 prot., datë 28.06.2022, kërkojmë zgjerimin dhe plotësimin e objektit të denoncimit duke pretenduar shkelje të nenit 91 edhe për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë z. Edison Memolla, subjekti zgjedhor Koalicioni Zgjedhor “Shtëpia e Lirisë”, kandidatin z. Hekuran Xhani, subjekti zgjedhor Partia Demokratike z. Ferdinand Saraçi.





31. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi pranimin e kërkesës së Organizatës “Qendresa Qytetare”, duke vijuar hetimin administrativ në lidhje me kërkesën e depozituar. Në vijim të seancës, e drejta për t’u shprehur dhe mbajtur qendrimin e tij, iu dha z. Eduart Dedej, i cili në pretendimet e tij deklaroi se i qendron pretendimeve të dhëna më shkresë nga zj. Margarita Dedej, Drejtor i Shkollës “Haxhi Qehaj”, duke deklaruar se data 16.02.2022 ka qenë ditë normale mësimi dhe mësimi ka vijuar deri në orën 13:50 si dhe nuk dhënë leje, miratim aprovim për pjesëmarrje të nxënësve të kësaj shkolle në inaugurimin e Qendrës Kulurore “Haxhi Qehaj”.
32. Në përfundim të seancës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve administroi kërkesën për zgjerim dhe plotësim të objektit të denoncimit duke ua përcjellë për njohje palëve në proces nëpërmjet shkresës nr. 2800 prot., datë 28.06.2022.
33. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2799 prot., datë 28.06.2022, bazuar në përcaktimet e nenit 47 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ka njoftuar palët zyrtarisht dhe në mënyrë elektronike për zhvillimin e seancës dëgjimore, më datë 30 Qershor 2022, ora 11:00, me palë Organizata “Qendresa Qytetare” ndaj z. Edison Memolla, kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, z. Denis Dedej, përgjegjës i Qendrës Kulurore “Haxhi Memolla”, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogzhinë, zj. Margarita Dedej, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe zj. Mimoza Bidaj, Drejtorit të Kopështit “Rrogzhinë”. Seanca dëgjimore u shty për më datë 28 Qershor 2022, për shkak të disa arsyeve objektive të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Palët u njoftuan elektronikisht për zhvillimin e seancës dëgjimore.
34. Në seancë dëgjimore u paraqitën përfaqësuesit e Organizatës “Qendresa Qytetare”, zj. Teisa Kurti dhe z. Migen Qiraxhi. Palët e tjera nuk u paraqitën. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të hetimit administrative pas administrimit të kërkesës për zgjerim dhe plotësim të objektit të denoncimit, ju dha të drejtën e fjalës përfaqësuesve të Organizatës “Qendresa Qytetare”, për të parashtruar pretendimet përfundimtare, të cilët deklaruan se i qendrojnë pretendimeve të depozituara me shkrim në seancat e kaluara, duke kërkuar përfundimisht marrjen e sanksioneve administrative për palët në process, konform dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

### III. Analiza ligjore

35. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se, në kuptim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se **“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër**



muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”, veprimtaria e kryer në ambientet e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” është një veprimtari me karakter publik pasi ka pasur pjesëmarrjen e publikut.

36. Referuar nenit 92, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se “*Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve*”. Nga materialet e dosjes hetimore dhe nga të dhënat e marra nga ndërfaqja e raportimit, rezultoi se aktiviteti është kryer në datën 16.02.2022, ora 17:00, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sportit dhe me folës kryesor, Kryetarin e Bashkisë z. Edison Memolla. Raportimi i kryer në datën 11.02.2022, në ndërfaqen “Aktivitetet e raportuara”, në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka pasur si vend të zhvillimit të aktivitetit qendër Rrogzhinë, Pallati i Kulturës. Në përpmbushje të kërkesave të nenit 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, ky aktivitet është raportuar 5 (pesë) ditë para zhvillimit të aktivitetit.

37. Ndërfaqja “aktivitetet e raportuara” është krijuar si një formë për raportim **vetëm për institucionet publike** dhe veprimtarinë e tyre, në mënyrë që të kryhet një vlerësim paraprak nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për keqpërdorim të fondeve publike në periudhë zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kur kategorizon një aktivitet të raportuar si të ndaluar apo jo, vlerëson nëse ky aktivitet plotëson kriteret ligjore **vetëm** për aq sa institucioni raportues shprehet.

38. **Inagurimi i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” nga kryetari i bashkisë**, me pjesëmarrjen e të ftuarve, në thelb nuk përbën veprimtari të ndaluar, për aq kohë sa:

1- gjatë veprimtarisë nuk ka thirrje për mbështetje elektorale apo vendosje të materialeve propagandistike, por aktiviteti ka si qëllim vetëm rifillimin e aktivitetit apo vënien në funksion të kësaj qendre që ka qenë në restaurim, nëpërmjet fondit të vënë në dispozicion nga një fondacion zvicerian.

2- fondet e përdorura nuk janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve

Menjëherë pas raportimit, në rastet kur ka indicje se veprimtaria mund të përbëjë “veprimtari të ndaluar” në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kryen kërkime mbi këtë aktivitet. Veprimtaria e kryer nga Kryetari i Bashkisë Rrogzhinë për inagurimin e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” nuk mund të konsiderohet një veprimtari e ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1.1, shkronja “b” dhe “d” ku parashikohet se:

1.1 “*veprimtari të ndaluar për tu promovuar*” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde



**publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:**

- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;
- d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

39. Në rastin konkret, referuar faqes zyrtare të Bashkisë Rrogozhinë, në link-un <http://ëëë.bashkiarrogozhine.gov.al/index.php/17-njoftime-shpallje/50-qendra-kulturore-e-rrogozhine>, bashkia Rrogozhinë ka dhënë informacione të mjaftueshme në lidhje me financimin (të cilat janë donacione private) dhe me periudhën se kur kanë nisur punimet në Qendrën Kulturore “Haxhi Memolla”. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të institucionit konsiderohet informacion zyrtar dhe merret për bazë si i tillë. Në lidhje me përmbajtjen e takimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të hamendësojë, por shprehet vetëm për aq sa është raportuar nga institucioni.
40. Gjithashtu, funksioni i “Kryetarit të Bashkisë” duhet të shihet i ndarë nga ai i “Kandidatit për Kryetar të Bashkisë” dhe nuk duhet të konfondohen. Nëse aktiviteti do të ishte takim elektoral, atëherë institucioni nuk do kishte detyrimin për raportim, pasi nuk do të konsiderohej aktivitet i institucionit por aktivitet i kandidatit për kryetar dhe në këtë rast do të kishim përdorim të fondeve publike pasi do ishin vënë në dispozicion dhe mbështetje të kandidatit burime publike (ambientet dhe punonjës të administratës).
41. Në mënyrë që promovimi apo mbështetja e investimeve të konsiderohet i ndaluar, duhet që të kemi vënie rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo transferim të fondeve publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve që në mënyrë eksplicite parashikohen nga vendimi nr. 9/2020, të Komsionit Rregullator. Në rastin konkret, referuar dhe shkresës nr. 913/1 prot., datë 10.03.2022, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 1637/1/2 prot., datë 15.03.2022 fondet për rindërtimin e kësaj qendre janë lëvruar në vitin 2020 dhe vijnë nga donacione private. Kategoritë e veprimtarive të ndaluara për promovim, nuk duhet të lexohen të ndara nga kushtet paracaktuese që e bëjnë këtë veprimtari të ndaluar. Kushtet janë komulative dhe në mënyrë që të kemi shkelje duhet të kemi shkeljen e të dyja kushteve.
42. Pjesëmarrja e Kryetarit të bashkisë dhe njëherësh kandidat provohet se është në përmbushje të detyrave të tij funksionale. Gjatë veprimtarisë nuk kishte material propagandistike të subjektit zgjedhor dhe as thirrje për të votuar atë.

43. Provohet pjesëmarrja e grupit artistik të nxënësve të shkollës gjatë orarit mësimor, por për sa kohë nuk jemi përpara një aktiviteti elektorral nuk përbën shkelje të ndalimeve të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
44. Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezulton se aktiviteti i kryer nga Bashkia Rrogozhinë, të jetë në shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.
45. Në lidhje me shtimin dhe plotësimin e objektit të denoncimit nga ana e Organizatës “Qendresa Qytetare”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve hetoi administrativisht dhe mori në shqyrtim të gjitha provat e depozituara në seancë publike dhe arriti në përfundimin se subjektet zgjedhore të cilat kanë propozuar kandidatët për kryetar bashkie në zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, përkatësisht subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia Demokratike” dhe Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, nuk mund të përfshihet në këtë procedim administrativ, pavarësisht se ajo ka qenë subjekt i denoncimit për këtë arsye nuk mund të jetë subjekt i hetimit administrativ, kjo mbështetur në vendimin nr. 19, datë 31. 05.2022 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve ku thuhet se *“në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022 ishin zgjedhje për kryetar bashkie, por jo për këshillat bashkiake. Për shkak se kandidati për kryetar bashkie trajtohet nga Kodi si subjekt zgjedhor i mëvetësishëm, atëherë në këto zgjedhje duhet trajtuar subjekt zgjedhor përfitues kandidati dhe jo partia politike që e mbështet atë”*.
46. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes hetimore u provua se, përgjegjësi i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” ka vënë në dispozicion të subjekteve të ndryshme zgjedhore, ambientet e Qendrës Kulturore për kryerjen e aktiviteteve elektorale, kjo e provuar nëpërmjet fototve bashkëlidhur materialit të depozituar fizikisht dhe elektronikisht në adresë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga denoncuesi. Vënia në dispozicion e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, nga ana e përgjegjësit të kësaj qendre është bërë pa qëllim favorizimi të ndonjë subjekti politik. Nga sa u provua nga fotot edhe nga pohimet e përfaqësuesit të Bashkisë Rrogozhinë, qendra u është vënë në dispozicion subjekteve zgjedhore në mënyrë të paanshme sipas kërkesave të tyre. Qendra kulturore është një institucion publik dhe si i tillë duhet të përdoret vetëm për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar. Ligji ndalon vendosjen e intitucioneve publike ne favor të subjekteve zgjedhore për të garantuar një fushatë të barabartë për garuesit. Përgjegjësi i qendrës kulturore duhet të mbajë në konsideratë ndalimin ligjor për të mos përdorur institucionin publik për qëllime elektorale. Denoncuesi kishte si qëllim të nxirrte në pah favorizimin që i është dhënë kandidatit të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Edison Memolla duke përdorur institucionin publik për fushatën e tij elektorale. Provat shtesë të vëna në dispozicion ku procohet se qendra është vënë në dispozicion edhe për subjektet e tjera

zgjedhore, krijon bindjen se nuk ka favorizim të ndonjë subjekti zgjedhor. Gjithsesi, i tërhiqet vëmendja përgjegjësit të qendrës kulturore që në të ardhmen të respektojë kufizimet e ligjit për sa i përket vënies në dispozicion ambienteve të këtij institucioni.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimin nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj z. Edison Memolla kryetar i Bashkisë Rrogozhinë dhe kandidat për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Denis Dedej përgjegjës i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla, Rrogozhinë, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej Drejtor i Shkollës Haxhi Qehaj” Rrogozhinë, zj. Mimoza Bidaj Drejtor i Kopështit Rrogozhinë, z. Edision Memolla, z. Hekuran Xhani në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Ferdinand Saraçi në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike.
2. Moskonstatimin e shkeljes nga ana e z. Edison Memolla kryetar i Bashkisë Rrogozhinë dhe kandidat për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, z. Denis Dedej përgjegjës i Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, zj. Ana Dhamo Drejtor i Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, z. Luan Shehi Drejtor i Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogozhinë, zj. Margarita Dedej Drejtor i Shkollës “Haxhi Qehaj” Rrogozhinë, zj. Mimoza Bidaj Drejtor i Kopshtit Rrogozhinë, z. Hekuran Xhani në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”, z. Ferdinand Saraçi në cilësinë e kandidatit për kryetar bashkie propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike.





3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 22 Korrik 2022  
Nr. 185

“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qendresa Qytetare”, ndaj Kryetarit të Bashkisë Rrogzhinë, Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla”, Drejtorisë Rajonale Arsimore Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Rrogzhinë, Drejtorit të Shkollës “Haxhi Qehaj” dhe Drejtorit të Kopështit Rrogzhinë, për shkelje administrative në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”